INFORMATOR

PËR

SHKOLLAT E MESME TË LARTA



EDICIONI I

german cooperation
DEUTSCHE ZUSAMMENARBEIT

Implemented by
giz Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

KYC KOSOVAR YOUTH COUNCIL

Ky publikim u hartua nga KYC me mbështetjen e Qeverisë Gjermane përmes Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH. Opinionet e shprehura janë të autorit (ëve) dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e GIZ ose Qeverisë Gjermane.

FALENDERIM

Publikimi i këtij Doracaku Informues, dhe zbatimi i të gjithë projektit, nuk do të ishte i mundshëm pa mbështetjen e Qeverisë Gjermane përmes Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH.

Faleminderit gjithashtu Drejtorive Komunale të Arsimit (DKA) dhe Drejtuesve të Shkollave për gatishmërinë dhe lehtësimin e zbatimit të projektit, dhe mbledhjes së të dhënave për Doracakun Informues.

Nxënësit dhe stafin e KYC i falenderojmë për energjinë e pashterrshme dhe pozitive duke mbështetur njëri-tjetrin dhe KYC-in.

Falenderojmë Prof. Asoc. Liridona Jemini-Gashi për mbështetjen e saj profesionale në përpilimin e Doracakut dhe punën që bën për mbështetjen e adoleshentëve në Orientimin e Karrierës.

TABELA E PËRMBAJTJES

Falenderim 3
Hyrje 4
Rëndësia e Orientimit në Karrierë 5
Prishtinë 8
Mitrovicë 43
Therandë 66
Lipjan 93
Prizren 104
Vushtrri 126
Shtime 146
Skenderaj 154
Drenas 172
Gjakovë 182
Gjilan 201
Ferizaj 233

HYRJE

Të dashur nxënës,

Mirë se keni filluar leximin e Informatorit për Shkollimin e Mesëm të Lartë në komunën tënde!

Ky informator është formë e thjeshtuar me informacione të rëndësishme për nxënësit rreth vazhdimit të shkollimit të mesëm të lartë. Qëllimi përfundimtar i këtij informatori është pajisja me njohuri të nevojshme që nxënësit zgjedhjen e shkollimit të mesëm të lartë të e bëjnë bazuar në planifikim.

Pse është bërë ky informator?

Ky informator është zhvilluar në kuadër të projektit, "E ardhmja para", mbështetur nga GIZ Kosova në emër të Qeverisë Gjermane, me qëllim që të zhvillohet një proces demokratik për ngritjen dhe fuqizimin e Këshillit të Nxënësve në shkollat e mesme të ulëta në mënyrë që të forcohet roli i tyre në strukturën e shkollës për të kontribuar në përmirësimin e performancës së shkollës dhe më pas fuqizimi i këtij mekanizmi për të udhëhequr nxënësit në gjetjen dhe ndërtimin e tyre. vetë, duke iniciuar aktivitete në nivel shkolle që do të kontribuonin në ngritjen e kompetencave personale, psiko-sociale, emocionale, intelektuale dhe pjesëmarrëse të nxënësve.

Për të arritur këtë mision, janë përpiluar tri objektiva më specifikë si në vijim;

1) Themelimi dhe/ose fuqizimi i Këshillave të Nxënësve të Shkollës në 20 shkolla dhe promovimi i procesit demokratik i përzgjedhjes,
2) Themelimi dhe zhvillimi i mëtutjeshëm i studentëve për Orientimin në Karrierë në shkolla, përmes mësimdhënësve dhe këshillave të nxënësve dhe
3) Zhvillimi dhe dizajnimi i një Udhëzuesi për Shkollim të Mesëm të Lartë, që do të rriste njohuritë e nxënësve sa i përket mundësive për edukim.

Kush jemi ne?

Këshilli Rinor Kosovar (KYC) është organizatë jo-qeveritare që aspiron të punojë drejt ndërtimit të një shoqërie të shëndoshë përmes promovimit të iniciativës, mbështetjes së të rinjve, angazhimit të vajzave dhe djemve në procese vendimmarrëse, fuqizimit të kapaciteteve të tyre, përfaqësimit të zërit rinor, promovimit të edukimit të vetë organizuar dhe mbështetjen e zhvillimit të politikave rinore. Të rinjtë, pra, janë motori i organizatës me të cilët ne synojmë të rrisim cilësinë në arsim.

Një ndër format kryesore të punës drejt sigurimit të cilësisë së edukimit në vend është angazhimi në krijimin dhe funksionalizimin e këshillave të nxënësve në shkolla dhe mirëmbajtjen e strukturës, e cila përfaqëson nxënësit e shkollave të mesme të larta në Kosovë, Këshillin e Nxënësve të Kosovës. KYC, në vitin 2005 ka themeluar strukturën më të madhe përfaqësuese të nxënësve të shkollave të mesme të larta – Këshillin e Nxënësve të Kosovës. Përbëhet nga 106 përfaqësues nga 106 shkolla të mesme në 30 komuna të Kosovës. Kjo strukturë kombëtare përfaqëson të gjithë nxënësit e shkollave të mesme, mbron interesat dhe të drejtat e nxënësve dhe bashkëpunon me zyrtarë, prindër, mësimdhënës dhe institucione të tjera arsimore në të mirë të të gjithë sistemit arsimor.

Rëndësia e Orientimit në Karrierë

Vendimet për të ardhmen, veçanërisht vendimmarrja në dimensionin e karrierës nuk është barrë e lehtë. Ky proces përfshin gjetjen e përgjigjeve për pyetje qe kanë të bëjnë me procesin e vet njohjes/vetëndërgjegjësimit si: kush jemi ne, çfarë jemi të aftë ne, kush dëshirojmë të jemi ne, dhe cilat janë opsionet e duhura të karrierës. Në moshën 14/15 vjeçare, pas përfundimit të shkollimit të mesëm të ulët, pritet të jemi gati të vazhdojmë në ciklin tjetër të edukimit, i cili do të shërbejë si bazë për një karrierë të suksesshme.

Në librin (2021) e publikuar nga Prof. Asoc. Liridona Jemini-Gashi *"Planifikimi dhe vendimmarrja për karrierë tek adoleshentët: Udhëzime teorike dhe praktike"* i cili shtjellon më saktësisht vendimmarjen për karrierë në moshën e adoleshencës, ajo thekson se të njohësh veten, profesionet dhe kombinimet mes tyre përfshin bazat e planifikimit të suksesshëm për karrierë.

Tutje, i vihet theks rëndësisë së mbështetjes së të rinjve nga familja, shkolla dhe bashkëmoshatarët në këtë proces të vetëvlerësimit dhe njohjes së profesioneve.

Ndaj dhe ky informator tenton të lehtësojë rrugëtimin e vendimmarrjes për shkollim të mesëm të lartë, duke ofruar informata administrative dhe përmbajtësore mbi atë se çfarë përfaqëson një shkollë përkatëse.

Ky informator (i cili ofron informacione për karrierë) pritet të përdoret nga nxënësit pëgjatë shkollimit të tyre fillor, në versionin online ose fizik gjatë hulumtimit për opsionet/mundesitë e përzgjedhjes së shkollimit të mesëm të lartë. Ky informator mund të përdoret edhe nga mësimdhënësit dhe këshilltarët e karrierës/psikologët shkollorë/pedagogët me qëllim të mbështetjes së nxënësve në rrugëtimin e karrierës.

Gjithashtu, prindërit/kujdestarët mund të informohen, dhe mbështesin nxënësit përgjatë rrugëtimit të karrierës.

Puna dhe aktivitetet e KYC në Orientimin për Karrierë në shkollat kampione

Projekti “E ardhmja para” ka implementuar aktivitetet në 20 shkollat kampione të GIZ, në 13 komuna të Republikës së Kosovës, përkatësisht Prishtinë, Prizren, Mitrovicë, Ferizaj, Gjakovë, Gjilan, Drenas, Deçan, Skënderaj, Vushtrri, Lipjan, Shtime dhe Therandë.

Fillimisht, janë bërë vizita në këto shkolla dhe janë realizuar takime me drejtuesit e shkollave, me qëllim të mbështetjes së themeliit të Këshillave të Nxënësve në shkollë siç edhe definohet me Ligjin e Arsimit Parauniversitar (04/L-032). Përveç ndihmës, nxënëve iu është ofruar gjithashtu udhëzues të thjeshtëzuar sa i përket procesit të përzgjedhjes së Këshillit të Nxënësve.

Tutje, me Këshillat e Nxënësve të përzgjedhur dhe mësimdhënës entuziastë është punuar drejt krjimit të një plani punues për të gjithë vitin rreth orienimit në karrierë, dhe punës së Këshillit në këtë drejtim.

Bazuar në këtë plan, KYC tutje ka trajnuar nxënësit në temën e Digjitalizimit dhe Ndërmarrësisë. Janë organizuar dy punëtori për secilën shkollë me 20 pjesëmarrës për shkollë, pra 40 punëtori me 800 nxënës përfitues.

Si rezultat, janë krijuar 20 grupe të rrjeteve sociale (një për shkollë), për t'u menaxhuar tutje nga nxënësit, me fokus të veçantë të përdoret për njoftimin e nxënësve tjerë rreth mundësive të karrierës. Eshtë organizuar Aktiviteti, më saktësisht Panairi "Ditës së Karrierës", ku për shkollë kanë marrë pjesë rreth 100 nxënës, pra total 1200 nxënës të informuar për profesione të ndryshme dhe llojet e mundësive për shkollim të mesëm të lartë, gjithashtu qasje në testim të interesave me qëllim të Orientimit në Karrierë. Së fundmi, publikimi i Dorcakut Informues: Rruga drejt karrierës së ëndrrave.

PRISHTINA

Shkollat e Mesme të Larta Publike

Emri i shkollës	Lloji i shkollës - (Drejtimi/Profili)		Lëndët	Mundësitë e së ardhmës
Sami Frasheri	Drejtimi:	Gjimnaz natyror	Gjuhë shqipe dhe letërsi, Matematikë, Biologji, Kimi, Fizikë, Astronomi, Gjuhë Angleze, Gjuhë Gjermane, Psikologji, Filozofi, Edukatë Fizike, Teknologji e informacionit dhe komunikimit, Latinisht, Gjuhë frënge, Histori, Art muzikor, Art figurativ, Filozofi, Gjeografi.	Biologë, Kimistë, Fizicientë, Shkencëtarë Mjedisor, Bioteknologë, Astrologë, Analizues të të dhënave, Inxhinierë mekanik, Inxhinierë elektrik, Inxhinierë kimik, Inxhinierë civil, Hulumtues të shkencave të ndryshme, Mësimdhënës, Gjeografë, Profesionistë shëndetësor, Hulumtues farmaceutik, Psikologë, etj.
	Profili:	Shkenca natyrore		
Xhevdet Doda	Drejtimi:	Gjimnaz natyror	Gjuhë shqipe dhe letërsi, Matematikë, Gjuhë angleze, Gjuhë gjermane, Art muzikor, Art figurativ, Biologji, Fizikë, Kimi, Gjeografi, Histori, Psikologji, Filozofi dhe logjikë, Teknologji e informacionit dhe komunikimit, Edukatë fizike.	Biologë, Kimistë, Fizicientë, Shkencëtarë Mjedisor, Bioteknologë, Astrologë, Analizues të të dhënave, Inxhinierë mekanik, Inxhinierë elektrik, Inxhinierë kimik, Inxhinierë civil, Hulumtues të shkencave të ndryshme, Mësimdhënës, Gjeografë, Profesionistë shëndetësor, Hulumtues farmaceutik, Psikologë, etj.
	Profili:	Shkenca natyrore		
Eqrem Çabej	Drejtimi:	Gjimnaz shoqëror	Gjuhë shqipe dhe letërsi, Histori, Gjuhë angleze, Gjuhë gjermane, Teknologji e informacionit dhe komunikimit, Matematikë, Fizikë, Edukatë fizike, Sociologji, Psikologji, Filozofi dhe logjikë, Art figurativ, Art muzikor, Edukatë qytetare.	Punëtorë socialë, Specialistë të Burimeve Njerëzore, Analistë të Kërkimit të Tregut, Analistë të politikave, Zyrtar të Zhvillimit të Komunitetit, Specialist të Marrëdhënieve me Publikun, Koordinator në Organizata jo fitim prurëse, Gazetarë, Shkrimarë, Historianë, Gjuhëtarë, Mësimdhënës, etj.
	Profili:	Shkenca shoqërore		

Emri i shkollës	Lloji i shkollës - (Drejtimi/Profili)		Lëndët	Mundësitë e së ardhmës
Ahmet Gashi	Drejtimi:	Gjimnaz shoqëror	Gjuhë shqipe dhe letërsi, Matematikë, Histori, Gjeografi, Kimi, Gjuhë angleze, Gjuhë frënge, Gjuhë gjermane, Psikologji, Sociologji, Filozofi, Art muzikor, Art figurativ, Teknologji e informacionit dhe komunikimit, Edukatë Fizike, Biologji, Fizikë.	Punëtorë socialë, Specialistë të Burimeve Njerëzore, Analistë të Kërkimit të Tregut, Analistë të politikave, Zyrtar të Zhvillimit të Komunitetit, Specialist të Marrëdhënieve me Publikun, Koordinator në Organizata jo fitim prurëse, Gazetarë, Shkrimarë, Historianë, Gjuhëtarë, Mësimdhënës, etj.
	Profili:	Shkenca shoqërore		
Gjimnazi i Specializuar i Matematikës	Drejtimi:	Matematikor	Gjuhë shqipe dhe letërsi, Gjuhë angleze, Algjebër, Gjeometri I, Teoria e numrave, Inekuacionet, Kombinatorikë, Algoritmet dhe bazat e programimit, Teknologji e informacionit dhe komunikimit Fizikë, Kimi, Biologji, Gjeografi, Histori, Edukatë fizike dhe shëndetësore, Gjuhë gjermane, Analizë me algjebër, Gjeometri II, Trigonometri, Teoria e probabilitetit, Organizimi dhe arkitektura e kompjuterit, Bazat e të dhënave të SQL, Aplikacione kompjuterike, Astronomi, Sociologji, Analizë matematikore, Algjebër II, Statistikë, Matematikë Financiare, Programimi i avancuar, Grafikë kompjuterike – nëpërmjet programit JAVA, Filozofi.	Matematicientë, Ekspertë të Statistikës, Analistë të të dhënave, Analistë Financiar, Analistë të Kërkimeve Operacionale, Programues Kompjuterik: Kriptografë, Shkencëtarë Hulumtues, Profesorë Kolegji, etj.
	Profili:	Matematikor		

Emri i shkollës	Lloji i shkollës - (Drejtimi/Profili)		Lëndët	Mundësitë e së ardhmës
Alaudin	Drejtimi:	Medrese	Gjuhë shqipe dhe letërsi, Gjuhë arabe, Gjuhë angleze, Gjuhë turke, Fikh, Kur'an, Akaid, Shkencat e Hadithit, Shkencat e Kur'anit, Moral Islam, Psikologji, Tefsir, Hadith, Usul Fikh, Dave, Filozofi Islame, Sociologji, Matematikë, Fizikë, Kimi, Biologji, Gjeografi, Teknologji e informacionit dhe komunikimit, Histori, Edukatë Fizike, Histori Islame, Ahlak.	Dijetarë të Islamit, Imam, Edukatorë të Islamit, Këshilltarë të Islamit, Shkrimtarë ose Gazetar pët Islamin, Punonjës të OJQ-së Islame, Profesionistë të financave islame, Përkthyes, Hulumtues në studime islame, Teologë, etj.
	Profili:	Medrese		



Emri i shkollës	Lloji i shkollës - (Drejtimi/Profili)		Lëndët	Mundësitë e së ardhmës
Hoxhë Kadri Prishtina	Drejtimi:	Ekonomike - Juridike	*Lëndët e përgjithshme:* Gjuhë shqipe dhe letërsi, Edukatë fizike, Matematikë, Teknologji e informacionit dhe komunikimit, Gjuhë angleze, Edukatë qytetare, Gjeografi. *Modulet profesionale:* Shpenzime afariste, Vendi dhe tregu, Hyrje në marketing, Hyrje në ekonomi, Shitje - promocioni i shitjes, Njohje malli, Hyrje në ekonomi, Ndërmarrësi, E drejta biznesore, Financë, Praktikë, Kontabiliteti, Statistikë, Komunikim biznes, E drejta, Struktura dhe zhvillimi i ndërmarrjes, Marketing, Format e pronësisë në afarizëm, Shpenzime afariste, Biznesi dhe ligjet në BE, Tregtia ndërkombëtare, Sistemi dhe sigurimi bankar në Kosovë, Marketing i avancuar, Planifikimi i shitjes, Praktikë profesionale.	Specialistë/Koordinatorë marketingu, Analistë të hulumtimit të tregut, Perfaqesues të Shitjeve, Analistë financiarë, Konsulentë të Biznesit, Ekzekutivë të reklamave, Sipërmarrës, Specialistë të Marrëdhënieve me Publikun, etj.
	Profili:	Ekonomi - Nëpunës i marketingut dhe shitjes		

Emri i shkollës	Lloji i shkollës - (Drejtimi/Profili)		Lëndët	Mundësitë e së ardhmës
Hoxhë Kadri Prishtina	Drejtimi:	Ekonomike - Juridike	*Lëndët e përgjithshme:* Gjuhë shqipe dhe letërsi, Matematikë, Gjuhë angleze, Histori, Edukatë fizike, Gjuhë gjermane, Edukatë qytetare, Teknologji e informacionit dhe komunikimit. *Modulet profesionale:* E drejta e punës, Ndërmarrësi, Praktikë, Statistikë, Punë në zyre, Bazat e së drejtës, Bazat e evidencës amë, Bazat e së drejtës administrative, E drejta trashëgimore, Bazat e së drejtës familjare dhe trashëgimore, Arkivistikë, sigurimi social, Korrespodencë dhe komunikim me palë, Punët e qarkullimit juridik, Praktikë profesionale, E drejta e pronësisë, Kushtetuta dhe të drejtat e qytetarëve, Baza e procedurës administrative, Procedurat administrative, E drejta evropiane, Konfliktet administrative, Veprimtari administrative, Shkrim ligjor, Bazat e së drejtës së punës, Shkrim ligjor, E drejta e sigurimit social, Bazat e së drejtës penale.	Zyrtarë ligjorë, Sekretarë Ligjor, Nëpunës të Gjykatës, Asistentë të kërkimeve ligjore, Asistentë të Ndihmës Juridike, Juristë, Adminisrarorë të kontratës, Asistentë Administrativ në Departamentet Ligjore, etj.
	Profili:	Administratë - Asistent juridik		
	Drejtimi:	Ekonomike - Juridike	*Lëndët e përgjithshme:* Gjuhë shqipe dhe letërsi, Gjuhë angleze, Edukatë fizike, Teknologji e informacionit dhe komunikimit, Matematikë, Edukatë qytetare. *Modulet profesionale:* Gjeografi ekonomike, Statistikë, Kontabilitet, Hyrje në ekonomi, Ndërmarrësi, Edukatë biznesore, Shpenzime afariste, Ekonomi, Hyrje në marketing, Vendi dhe tregu, Etika në punë, Financë, Baza e së drejtës dhe e drejta, Njohje e mallit, Komunikim biznesi, Afarizëm komercial, Afarizëm bankar, Praktikë profesionale.	Kontabilistë tatimor, Analistë financiar, Auditorë, Analistë buxhetor, Konsulentë tatimor, Planifikues financiar, Kontabilistë të korporatës, Këshilltarë Financiar Personal: Kontabilistë të Mjekësisë Ligjore, etj.
	Profili:	Ekonomi - Nëpunës i kontabilitetit dhe tatimeve		

Emri i shkollës	Lloji i shkollës - (Drejtimi/Profili)		Lëndët	Mundësitë e së ardhmës
Hoxhë Kadri Prishtina	Drejtimi:	Ekonomike - Juridike	*Lëndët e përgjithshme:* Gjuhë shqipe dhe letërsi, Edukatë fizike, Edukatë qytetare, Gjuhë angleze, Teknologji e informacionit dhe komunikimit, Matematikë. *Modulet profesionale*: Statistikë, Njohje malli, Kontabiliteti, Ndërmarrësi, Praktikë profesionale, E drejta biznesore, Gjeografi ekonomike, Hyrje në ekonomi, Financë, Ekonomi, Afarizëm komercial, Bazat e sigurimeve, Vendi i tregut, Kontabiliteti, Komunikim biznesi, E drejta, struktura dhe zhvillimi i marrëdhënies, Marketing, Format e pronësisë në afarizëm, Shpenzime afariste, Biznesi dhe ligjet në BE, Tregtia ndërkombëtare, Sigurimi dhe sistemi bankar në Kosovë, Sistemi financiar dhe revizioni, Kontabiliteti i drejtimit, Bazat e së drejtës dhe e drejta, Komunikim biznesi, Afarizëm bankar, Marketing.	Nëpunës banke, Përfaqësues të Shërbimit të Klientit, Përpunuesi të kërkesave të sigurimit, Ndihmës të Kredive, Asistentë të Sigurimit, Përfaqësuesi të Shërbimeve Financiare, Asistentë të Operacioneve Bankare, Agjentë të shitjeve të sigurimeve, Asistentë të Analistit Financiar, etj.
	Profili:	Ekonomi - Nëpunës për banka financa dhe sigurime		
	Drejtimi:	Ekonomike - Juridike	*Lëndët e përgjithshme:* Gjuhë shqipe dhe letërsi, Gjuhë angleze, Matematikë, Edukatë qytetare, Edukatë fizike, Teknologji e informacionit dhe komunikimit. *Modulet profesionale:* Hyrje në shpenzime afariste, Ndërmarrësi, Kontabilitet, E drejta biznesore, Statistikë, Njohuri mallrash, Hyrje në ekonomi, Gjeografi ekonomike, Financa, Praktikë profesionale, Ekonomi, Bazat e transportit dhe bartjes, Menaxhimi i logjistikës, Menaxhimi i deposë, Vendi dhe tregu, Financa, Kontabilitet, Doganë, Bazat e së drejtës dhe e drejta, Komunikim biznesi, Menaxhimi i logjistikës, Depo afariste, Marketing.	Koordinator të Logjistikës, Analistë të zinxhirit të furnizimit, Mbikëqyrës të magazinës,
	Profili:	Ekonomi - Nëpunës i shpedicionit dhe logjistikës		

Emri i shkollës	Lloji i shkollës - (Drejtimi/Profili)		Lëndët	Mundësitë e së ardhmës
28 Nëntori	Drejtimi:	**Teknike**	*Lëndët e përgjithshme*: Gjuhë shqipe dhe letërsi, Gjuhë angleze, Gjuhë gjermane, Matematikë, Edukatë qytetare, Fizikë, Kimi, Edukatë fizike. *Modulet profesionale*: Teknologji e informacionit dhe komunikimit, Ekonomi dhe ndërmarrësi, Vizatim teknik, Konstruksione ndërtimore, Auto CAD, Gjeometri deskriptive, Materialet ndërtimore, Mekanika teknike, Teknologjia e ndërtimit, Konstruksionet e betonit, Konstruksionet e drurit dhe çelikut, Instalimet e ujësjellsit dhe kanalizimeve dhe teknologjia e betonit, Praktikë profesionale.	Menaxherë të projektit të ndërtimit, Vlerësues ndërtimi, Mbikëqyrës të Hapësirës të Ndërtimit, Inspektorë ndërtimi, Punonjës të ndërtimit, Elektricistë ndërtimi, Operatorë të pajisjeve të ndërtimit, Teknikë ndërtimi , etj.
	Profili:	**Ndërtimtari - Ndërtimtari**		
	Drejtimi:	**Teknike**	*Lëndët e përgjithshme:* Gjuhë shqipe dhe letërsi, Gjuhë angleze, Gjuhë gjermane, Matematikë, Fizikë, Edukatë qytetare, Edukatë fizike. *Modulet profesionale:* Teknologji e informacionit dhe komunikimit, organizimi i punës në ndërmarrje, Vizatim i lirë, Gjeometri dhe perspektivë, Kompozicionet arkitektonike, Bazat e projektimit, Materialet ndërtimore, Konstruksionet arkiteknike, CAD disenjimi me anë të kompjuterit, Elementet e projektimit I dhe II, Mekanikë teknike, Zhvillimi i arkitekturës dhe njohuri mbi restaurimin, punimi i projekteve të thjesht me CAD në 2D dhe 3D, instalimet në objekte, Konstruktimi i peisazheve të thjeshta arkitektonike, Projektimi dhe rregullimi i interierit, Perceptimi i hapësirës, Punimi i modeleve të thjeshta arkitektonike.	Asistentë të arkitektëve, Planifikues urbanistik, Konsulentë, Koordinatorë të Projektit të Ndërtimit, Inspektorë ndërtimi, Specialistë të ruajtjes së historisë, Zhvillues të pasurive të patundshme, Menaxher të objekteve, Dizajner të brendshëm, Hulumtues të Dizajnit, Arkitektë, Teknikë të CAD-it, Shkrimtarë ose kritikë arkitekturor, etj.
	Profili:	**Ndërtimtari - Arkitekturë**		

Emri i shkollës	Lloji i shkollës - (Drejtimi/Profili)		Lëndët	Mundësitë e së ardhmës
28 Nëntori	Drejtimi:	**Teknike**	*Lëndët e përgjithshme:* Gjuhë shqipe dhe letërsi, Gjuhë angleze, Gjuhë gjermane, Matematikë, Edukatë qytetare, Edukatë fizike, Fizikë, Gjeografi. *Modulet profesionale*: Teknologji e informacionit dhe komunikimit, Ndërmarrësi, Gjeodezi, Llogaritjet e matjeve gjeodezike, Gjeometri deskriptive, Vizatim dhe shkrim gjeodezik, Fotogrametri, Gjeodezi inxhinierike, Gjeoinformatika, kadastri dhe operacionet agrare, Praktikë profesionale.	Gjeodetë, Teknikë të gjeomatikës, Hartografë, Analistë të sensorit në distancë, Analistë të të dhënave gjeohapësinore, etj.
	Profili:	**Ndërtimtari - Gjeodezi**		
	Drejtimi:	**Teknike**	*Lëndët e përgjithshme:* Gjuhë shqipe dhe letërsi, Gjuhë angleze, Gjuhë gjermane, Matematikë, Edukatë qytetare, Edukatë fizike, Fizikë. *Modulet profesionale*: Menaxhimi i projekteve, Teknologji e informacionit dhe komunikimit, Gjeografi e komunikacionit të post-telekomit, Bazat e elektroteknikës me elektronikë, Komunikacion postar, Bazat e ekonomisë, Rrjetat dhe digjitalizmi i të dhënave, Komunikacioni telefonik, Telekomunikimet, Teknika e PT-së, Bazat e menaxhmentit, Afarizmi financiar në ndërmarrje, Shërbimet dhe produktet në PTT, Automatizimi në PT, Ndërmarrësia, Ekonomi.	Punonjës të postës, Teknikë të Telekomunikacionit, Përfaqësuesi të Shërbimit të Klientit: Administratorë të Rrjetit, Inxhinierë të Telekomunikacioni, Analistë të të dhënave, Menaxherë të Projektit IT, Specialistë të Mbështetjes Teknike, Specialistë të Sigurisë së Rrjetit, etj.
	Profili:	**Komunikacion - Post Telekom**		

Emri i shkollës	Lloji i shkollës - (Drejtimi/Profili)		Lëndët	Mundësitë e së ardhmës
28 Nëntori	Drejtimi:	Teknike	*Lëndët e përgjithshme:* Gjuhë shqipe dhe letërsi, Gjuhë angleze, Gjuhë gjermane, Matematika aplikative, Edukatë qytetare, Edukatë fizike, Kimi. *Modulet profesionale*: Teknologji e informacionit dhe komunikimit, Ekonomia dhe ndërmarrësia, Formësimi grafik, Grafikë, Bazat e teknologjisë grafike, Materialet grafike, Makinat grafike, Dizajn grafik, Teknologjia e proceseve grafike, Historia e artit, Teori e formës, Shtyp, Fotoshop (TIK aplikativ), Bazat e elektroteknikës me automatikë.	Dizajnerë grafik: Artistë të Prodhimit të Printuar, Drejtorë Arti, Teknikë të para printimeve, Menaxherë të Prodhimit të Printimit, Teknikë të Printimit, Projektuesi të paketave, Projektuesi të publikimeve, Specialistë të marketingut të printimit, etj.
	Profili:	Grafikë-Grafikë shtypi		
	Drejtimi:	Teknike	*Lëndët e përgjithshme:* Gjuhë shqipe dhe letërsi, Gjuhë angleze, Gjuhë gjermane, Matematika aplikative, Edukata qytetare, Edukatë fizike, Kimi. *Modulet profesionale*: Teknologji e informacionit dhe komunikimit, Ekonomia dhe ndërmarrësia, Formësimi grafik, Grafikë, Bazat e teknologjisë grafike, Materialet grafike, Makinat grafike, Dizajn grafik, Teknologjia e procesve grafike, Historia e artit, Teoria e formës, Shtyp, Fotoshop (TIK aplikativ), Bazat e elektroteknikës me automatikë.	Dizajnerë grafik, Teknikë të prodhimit të printimit, Dizajnerë të uebit: Drejtorë të artit, Specialistë të imazhit dixhital, Asistentë të prodhimit, Ilustrues teknikë, Koordinator të marketingut, Sipërmarrës, etj.
	Profili:	Grafikë - Grafikë libërlidhje		
	Drejtimi:	Teknike	*Lëndët e përgjithshme:* Gjuhë shqipe dhe letërsi, Gjuhë angleze, Gjuhë gjermane, Matematika aplikative, Edukatë qytetare, Edukatë fizike, Kimi. *Modulet profesionale*: Teknologji e informacionit dhe komunikimit, Ekonomia dhe ndërmarrësi, Formësimi grafik, Grafikë, Bazat e teknologjisë grafike, Materialet grafike, Makinat grafike, Dizajn grafik, Teknologjia e proceseve grafike, Historia e artit, Teori e formës, Shtyp, Fotoshop (TIK aplikativ), Bazat e elektroteknikës me automatikë.	Dizajnerë grafik, Dizajnerë të multimedias, Projektues të uebit: Dizajnerë të UI/UX, Redaktues rë videos, Menaxherië të mediave sociale, Kreativë të reklamave, Prodhues të mediave, etj.
	Profili:	Grafikë - Grafikë Media		

Emri i shkollës	Lloji i shkollës - (Drejtimi/Profili)		Lëndët	Mundësitë e së ardhmës
Abdyl Frashëri	Drejtimi:	Bujqësisë	*Lëndët e përgjithshme:* Gjuhë shqipe dhe letërsi, Gjuhë angleze, Gjuha e dytë e huaj, Matematikë, Fizikë, Kimi e përgjithshme dhe inorganike, Kimi organike, Biologji, Edukatë Qytetare, Edukatë Fizike. *Modulet profesionale*: Teknologji e informacionit dhe komunikimit, Ndërmarrësi, Bazat e teknologjisë ushqimore 1, Bazat e teknologjisë ushqimore 2, Kimi analitike, Mikrobiologji ushqimore, Proceset themelore në industrinë ushqimore, Teknologjia e përpunimit të drithërave dhe të brumit, Teknologjia e përpunimit të mishit, Kontrollimi dhe siguria e prodhimeve ushqimore, Teknologjia e përpunimit të qumështit, Teknologjia e përpunimit të frutave dhe perimeve, Teknologjia e prodhimit të pijeve alkoolike.	Teknologë të Ushqimit, Teknikë të Sigurimit të Cilësisë, Shkencëtar të Ushqimit, Specialistë të Zhvillimit të Produkteve, Menaxherë të Sigurisë Ushqimore, Teknologë të pijeve, Inxhinierë të përpunimit të ushqimit, Teknikë të laboratorit ushqimor, Inspektorë të ushqimit, Sipërmarrës ushqimor, etj.
	Profili:	Teknologji ushqimore - Përpunues i ushqimit dhe profesioneve të ngjashme;		

Nuk do të keni një shans të dytë për të lënë përshtypjen e parë. - Coco Chanel

Emri i shkollës	Lloji i shkollës - (Drejtimi/Profili)		Lëndët	Mundësitë e së ardhmës
Abdyl Frashëri	Drejtimi:	Bujqësisë	*Lëndët e përgjithshme:* Gjuhë shqipe dhe letërsi, Gjuhë angleze, Matematikë, Teknologji e informacionit dhe komunikimit, Ekonomi dhe ndërmarrësi, Edukatë qytetare, Fizikë, Histori, Gjeografi, Psikologji, Menaxhim i projekteve, Gjuha e dytë e huaj. *Modulet profesionale*: Biologji, Kimi, Anatomi e kafshëve, Fiziologjia e kafshëve, Blegtoria, Patologjia e përgjithshme, Farmakologjia, Biokimi, Të ushqyerit e kafshëve, Sëmundjet e brendshme të kafshëve shtëpiake, Sëmundjet invazive, Lindshmëria veterinare, Riprodhimi dhe mbarsimi artificial, Kontrolli i cilësisë dhe siguria e prodhimeve me prejardhje shtazore, Praktikë profesionale.	Mjekë Veterinar, Teknikë të Veterinarisë, Asistentë të Veterinarit, Veterinarë të Patologjisë, Studiues të Veterinarisë, Farmacistë të Veterinarisë, Radiologë Veterinarisë, Kirurgë të Veterinarisë, Epidemiologë të Veterinarisë, Menaxherë të Praktikës Veterinare, Avokues të të Drejtave të Kafshëve, etj.
	Profili:	Bujqësi - Veterinari		



Emri i shkollës	Lloji i shkollës - (Drejtimi/Profili)		Lëndët	Mundësitë e së ardhmës
Abdyl Frashëri	Drejtimi:	Bujqësisë	*Lëndët e përgjithshme:* Gjuhë shqipe dhe letërsi, Gjuhë angleze, Matematikë, Teknologji e informacionit dhe komunikimit, Ekonomia dhe ndërmarrësia, Edukatë fizike, Edukatë qytetare, Fizikë, Histori, Gjeografi, Psikologji, Menaxhimi i projekteve, Gjuha e dytë e huaj. *Modulet profesionale:* Kimi aplikative, Biologji aplikative, Bazat mbi tokën dhe të ushqyerit e bimëve, Bazat e teknikës bujqësore, Prodhimtari bimore, Mekanizmi bujqësor, Prodhimtari blegtorale, Mbrojtje e bimëve, Marketingu dhe shitja e prodhimeve bujqësore, Kontabiliteti në agrobiznes, Financat në agrobiznes, Organizimi i prodhimtarisë bujqësore, Menaxhimi i fermës, Mbrojtje e ambienitit jetësor, Praktikë profesionale.	Menaxherë Bujqësorë, Analistë të Agrobiznesit, Ekonomistë Bujqësorë: Konsulentë të të Mbjellurave, Zyrtarët e Kredive Bujqësore, Analistë të Politikave Bujqësore, Përfaqësues të Shitjeve Bujqësore, Trajnerë, etj
	Profili:	Bujqësi - Agrobiznesi		

GJËJA MË E RËNDËSISHME NË JETËN TUAJ ËSHTË NË FUND TË FUNDIT KOHA JUAJ.
- ALAN LACAINE

Emri i shkollës	Lloji i shkollës - (Drejtimi/Profili)		Lëndët	Mundësitë e së ardhmës
Abdyl Frashëri	Drejtimi:	Bujqësisë	*Lëndët e përgjithshme:* Gjuhë shqipe dhe letërsi, Gjuhë angleze, Matematikë, Teknologji e informacionit dhe komunikimit, Ekonomia dhe ndërmarrësia, Edukatë fizike, Edukatë qytetare, Fizikë, Histori, Gjeografi, Menaxhimi i projekteve, Psikologji, Gjuhë e huaj e dytë. *Modulet profesionale*: Biologji, Kimi, Bazat e shkencës së tokës dhe të ushqyerit e bimëve, Teknikë bujqësore, Botanikë, Meteorologjia, Fitopatologji, Mikrobiologji, Makina dhe aparate, Bazat e prodhimtarisë bimore, Entomologji, Organizim i prodhimtarisë bimore, Prodhimtari organike, Barërat e këqia dhe luftimi i tyre, Praktikë profesionale.	Specialistë për Mbrojtjen e Bimëve, Agronomë, Menaxhimi i Integruar i Dëmtuesve (IPM), Konsulentë të korrave, Shkencëtarë kërkimor në mbrojtjen e bimëve, Analistë të cilësisë së farës, Përfaqësues të shitjeve për mbrojtjen e të korrave, Inspektorë të shëndetit të bimëve, etj.
	Profili:	Bujqësi - Mbrojtja e bimëve		



Emri i shkollës	Lloji i shkollës - (Drejtimi/Profili)		Lëndët	Mundësitë e së ardhmës
Abdyl Frashëri	Drejtimi:	Bujqësisë	*Lëndët e përgjithshme:* Gjuhë shqipe dhe letërsi, Gjuhë angleze, Matematikë, Teknologji e informacionit dhe komunikimit, Ekonomia dhe ndërmarrësia, Edukatë fizike, Edukatë qytetare, Fizikë, Histori, Gjeografi, Psikologji, Menaxhim i projekteve, Gjuha e dytë e huaj. *Modulet profesionale*: Biologji, Kimi, Bazat mbi tokën dhe të ushqyerit e bimëve, Teknikë bujqësore, Botanikë, Prodhimi i fidaneve, Mbrojtja e bimëve, Kultivimi i luleve njëvjeçare dhe qepore, Kultivimi i bimëve shumëvjeçare, Lulet e saksive, Rregullimi i kopshteve, Dekorimi i ambienteve të jashtme, Dendrologji, Praktikë profesionale.	Hortikulturistë, Menaxherë të fdanishtes: Projektuesi të peizazhit, Menaxherë të Qendrës së Kopshtit, Projektues të luleve: Menaxherë të Serrës, etj.
	Profili:	Bujqësi - Hortikulturë		

Gjëja më e rëndësishme për të bërë është të mendoni për veten tuaj.
- Coco Chanel

Emri i shkollës	Lloji i shkollës - (Drejtimi/Profili)		Lëndët	Mundësitë e së ardhmës
Shtjefën Gjeçovi	Drejtimi:	**Teknike**	*Lëndët e përgjithshme*: Gjuhë shqipe dhe letërsi, Gjuhë angleze, Edukatë fizike, Kimi, Edukatë qytetare, Psikologji, Teknologji e informacionit dhe komunikimit, Ekonomi e ndërmarrësi, Matematikë aplikative, Fizikë aplikative, Histori. *Modulet profesionale*: Materiale teknike, Vizatim teknik, Mekanikë teknike, Teknologjia e përpunimit për metalpunues II, Solid works, Praktikë profesionale, Detalet e makinave, Hidraulikë dhe pneumatikë, Elektroteknikë dhe elektronikë, Solid cam, Menaxhim i projektit, Teknologji e dirigjimit kompjuterik II (frezat), Automatizim dhe robotikë, Programer i makinave me dirigjim kompjutrerik, Teknologji e makinave kompjuterike të dirigjimit, Teknologji e dirigjimit Kompjuterik I (tornot), Proengineer I dhe II.	Inxhinierë Mekanik, Teknikë të CAD, Makinistë të CNC, Projektues Industrial, Inxhinierë të Automatizimit, Inxhinierë të Sistemit të Kontrollit, Inxhinierë Elektrikë, Teknikë Robotikë, Menaxherë të Projektit, Teknikë të Kontrollit të Cilësisë, etj.
	Profili:	**Elektroteknikë - Dirigjim kompjuterik**		
	Drejtimi:	**Teknike**	*Lëndët e përgjithshme*: Gjuhë shqipe dhe letërsi, Gjuhë angleze, Edukatë fizike, Gjuhë gjermane, Edukatë qytetare, Edukatë fizike, Teknologji e informacionit dhe komunikimit, Matematikë aplikative, Fizikë aplikative. *Modulet profesionale*: Materiale teknike, Vizatim teknik, Mekanikë teknike, Detalet e makinave, Teknologji e punimit për metalpunues I, Teknologjia e saldimit I, II, dhe III, Elektroteknikë dhe elektronikë, Konstruksione metalike 1, Konstruksione metalike 2, Vizatim me kompjuter (CAD), Ecuritë teknologjike të proceseve mekanike, Teoria e prodhimit dhe orgnizimi i ndërmarrjes, Hidraulikë dhe pneumatikë, Konstruksione metalike 1, Konstruksione metalike 2, Teknologji e punimit për metalpunues II, Makinat CNC për prerje dhe formësim, Teknologji e punimit për metalpunues III.	Fabrikues/Saldator të Metalit, Punonjës llamarine, Teknik të përpunimit të metaleve, Krijues të veglave, Inspektorë të përpunimit të metaleve, Skulptorë/Artistë të Metalit, Përfaqësues të shitjeve të përpunimit të metaleve, Instruktorë të përpunimit të metaleve, Sipërmarrës/Pronarë biznesi, etj.
	Profili:	**Makineri - Metalpunues**		

Emri i shkollës	Lloji i shkollës - (Drejtimi/Profili)		Lëndët	Mundësitë e së ardhmës
Shtjefën Gjeçovi	Drejtimi:	**Teknike**	*Lëndët e përgjithshme:* Gjuhë shqipe dhe letërsi, Gjuhë angleze, Gjuhë gjermane, Edukatë fizike, Edukatë qytetare, Teknologji e informacionit dhe komunikimit, Matematikë aplikative, Fizikë aplikative. *Modulet profesionale:* Vizatim teknik, Mekanikë teknike, Detalet e makinave, Teknologjia e profesionit, Elektroteknika në automjete, Elektronika në automjete, Teoria e prodhimit dhe organizimi i ndërmarrjes, .	Automekanikë, Teknikë automobilistik, Këshilltarë të Shërbimit të Automobilave, Specialistë të pjesëve të automobilave, Përfaqësues të Shitjeve të Automobilave, Menaxherë të shërbimit të automobilave, Inxhinierë automobilistik, Instruktorë për automobilë, Sipërmarrës automobilistik, Serviser të automjeteve, etj.
	Profili:	Makineri - Automekanik		
	Drejtimi:	**Teknike**	*Lëndët e përgjithshme:* Gjuhë shqipe dhe letërsi, Gjuhë angleze, Edukatë fizike dhe shëndetësore, Edukatë qytetare, Matematikë aplikative, Psikologji, Fizikë. *Modulet profesionale:* Materiale teknike, Vizatim teknik me dokumentim, Mekanikë teknike, Detalet e makinave, Teknologjia mekanike, Bazat e elektroteknikës, Teknikat e matjes, TIK dhe programim, Hidraulikë dhe Pneumatikë, Teoria e prodhimit dhe organizimi i ndërmarrjes, Bazat e elektronikës, Bazat e robotikës, Senzorët dhe aktuatorët, Elektronika digjitale, Detalet e makinave, Programet softuerike aplikative, Bazat e automatizimit, Bazat e teknikës së rregullimit, Vizatim me kompjuter, Elektronika digjitale, Teknologjia mekanike, Senzorët dhe akustorët, mikroprocesorët, Menaxhim i projekteve në mekatronikë.	Inxhinierë të Mekatronikës, Inxhinierë të Robotikës, Inxhinierë Automatizimi, Inxhinierë të sistemeve të kontrollit, Teknikë të shërbimit në terren, Teknikë të mirëmbajtjes industriale, Inxhinierë të zhvillimit të produktit, Teknikë të Kërkimit dhe Zhvillimit, Inxhinierë Teknik dhe të Shitjeve, Instruktorë ose trajner të mekatronikës, etj.
	Profili:	Elektroteknikë - Mekatronikë		

Emri i shkollës	Lloji i shkollës - (Drejtimi/Profili)		Lëndët	Mundësitë e së ardhmës
Shtjefën Gjeçovi	Drejtimi:	**Teknike**	*Lëndët e përgjithshme:* Gjuhë shqipe dhe letërsi, Gjuhë angleze, Gjuhë gjermane, Edukatë fizike, Edukatë qytetare, Teknologji e informacionit dhe komunikimit, Matematikë aplikative, Fizikë aplikative. *Modulet profesionale:* Materiale teknike, Vizatim teknik, Mekanikë teknike, Elektroteknikë dhe Elektronikë, Vizatim me kompjuter (CAD), Teknologji e IUK-NK (INK kl. 11, 12), Hidraulikë, Teknikë ndërtimi, Termodinamikë, Teoria e prodhimit dhe organizimi i ndërmarrjes.	Hidraulikë, Pipemontues, Inspektorë hidraulik, Teknikë të mirëmbajtjes së ndërtesave, Teknikë kullimi, Punëtorë ndërtimi, Operatorë të impiantit të trajtimit të ujit, Operatorë të impiantit të trajtimit të ujërave të zeza, Teknikë pompash, Specialistë për ruajtjen e ujit, Teknikë të ngrohjes, Përfaqësues të shitjeve të ngrohjes, etj.
	Profili:	**Makineri - Instalues ujësjellësi klimatizimit - ngrohjes klimatizimit**		
	Drejtimi:	**Teknike**	*Lëndët e përgjithshme:* Gjuhë shqipe dhe letërsi, Gjuhë angleze, Gjuhë gjermane, Matematikë, Kimi, Edukatë qytetare, Edukatë fizike. *Modulet profesionale:* Marketing/shitje, Teknologji e informacionit dhe komunikimit, Ndërmarrësi, Bazat e profesionit në floktari, Puna në recepcion dhe puna ekipore, Larja tharja dhe shtimi bazik, Teknikat e stilimit të flokëve (Fenirim/Figaro/frizura), Stilimet e flokëve (histori), Prerjet e flokëve, Permanenti i flokëve, Ngjyrosjet klasike – hapja flokut, Prerjet klasike, Prerje të avansuara, Ngjyrosjet të avansuar, Korigjime të flokut.	Stilues të flokëve, Menaxherë të salloneve të ondulimit Ngjyrosës të flokëve, Berberë, Stilistë të flokëve për nuse, Specialistë për zgjatjen e flokëve, Specialistë për mbjelljen e flokëve, Dizajnerë dhe stilistë të parukave, Konsulentë për sallonit, etj.
	Profili:	**Floktari - Floktari**		

Emri i shkollës	Lloji i shkollës - (Drejtimi/Profili)		Lëndët	Mundësitë e së ardhmës
Shtjefën Gjeçovi	Drejtimi:	**Teknike**	*Lëndët e përgjithshme:* Gjuhë shqipe dhe letërsi, Gjuhë angleze, Edukatë fizike, Gjuhë gjermane, Edukatë qytetare, Psikologji, Teknologji e informacionit dhe komunikimit, Ekonomi e ndërmarrësi, Matematikë aplikative, Fizikë aplikative, Menaxhimi i projekteve. *Modulet profesionale:* Vizatim me kompjuter CAD, Vizatim i lirë modelesh, Fibrat e tekstilit, Teknologji e konfeksionit, Teknologji e tekstilit, Estetika e rrobave, Hulumtimet e tekstilit, Konstruktim dhe modelim i veshjeve, Praktikë profesionale.	Studiues të tekstilit, Teknologë të tekstilit, Prodhues të modeleve, Inspektorë të kontrollit të cilësisë, Koordinatorë të prodhimit, Studiues të tekstilit, Tregtarë të modës, Përfaqësues të shitjeve të tekstilit, Blerës të tekstilit, Sipërmarrës, etj.
	Profili:	**Tekstil - Konfeksion**		
	Drejtimi:	**Teknike**	*Lëndët e përgjithshme:* Gjuhë shqipe dhe letërsi, Gjuhë angleze, Gjuhë gjermane, Edukatë fizike, Edukatë qytetare, Psikologji, Kimi, Teknologji e informacionit dhe komunikimit, Ekonomi e ndërmarrësi, Matematikë aplikative, Fizikë aplikative, Gjeografi, Histori. *Modulet profesionale*: Vizatim i lirë modelesh, Hulumtimet e tekstilit, Konstruktim dhe modelim i veshjeve, Materialet e rrobaqepësisë, Teknologji e veshjeve, Estetika e veshjeve, Përgatitja e veshjeve për meshkuj, Praktikë Profesionale, Vizatim me kompjutor (CAD).	Dizajnerë të modës, Rrobaqepës, Kostumbërës, Prodhuesi i mostrave, Stilistë të modës, Teknikë të veshjeve, Sipërmarrës të modës, Edukatorë tëi modës, etj.
	Profili:	**Tekstil - Rrobaqepësi**		

Emri i shkollës	Lloji i shkollës - (Drejtimi/Profili)		Lëndët	Mundësitë e së ardhmës
Shtjefën Gjeçovi	Drejtimi:	**Teknike**	*Lëndët e përgjithshme:* Gjuhë shqipe dhe letërsi, Gjuhë angleze, Edukatë fizike, Kimi, Edukatë qytetare, Teknologji e informacionit dhe komunikimit, Ekonomi dhe ndërmarrësi, Matematikë aplikative, Fizikë aplikative, Menaxhimi i projektit, Gjeografi, Histori. *Modulet profesionale:* Vizatim teknik, Mekanikë teknike, Njohuri për mjetet e transportit rrugor, Bazat e transportit rrugor, Elektroteknikë e mjeteve të transportit, Mirëmbajtja e mjetit transportit rrugor, Siguria në trafikun rrugor I, Rrugët dhe objektet rrugore, Shenjat e trafikut dhe sinjalet rrugore, Mjekësia dhe psikologjia në trafikun rrugor, Rregullimi i trafikut rrugor, siguria në trafikun, Metodat e aftësimit në ngasje të mjetit, Praktika profesionale.	Shoferë të automjeteve të rënda, Koordinatorë të Logjistikës, Planifikues të Transportit, Mbikëqyrës të Dispeçimit, Ndërmjetës të Transportit, Menaxherë të Trafikut, Inspektorië të Sigurisë së Transportit, Teknikë të mirëmbajtjes së automjeteve, Analistë të transportit, etj.
	Profili:	**Transport dhe trafik - Trafik rrugor**		

Emri i shkollës	Lloji i shkollës - (Drejtimi/Profili)		Lëndët	Mundësitë e së ardhmës
Shtjefën Gjeçovi	Drejtimi:	**Teknike**	*Lëndët e përgjithshme:* Gjuhë shqipe dhe letërsi, Gjuhë angleze, Edukatë fizike, Kimi, Edukatë qytetare, Teknologjia e informacionit dhe komunikimit, Ekonomi e ndërmarrësi, Matematikë aplikative, Fizikë aplikative, Menaxhim i projektit, Gjeografi, Histori. *Modulet profesionale:* Vizatim teknik, Mekanikë teknike, Njohuri për mjetet e transportit rrugor, Bazat e transportit rrugor, Elektroteknikë e mjetit të transportit, Mirëmbajtja e mjetit të transportit rrugor, Siguria në trafikun rrugor I, Shenjat e trafikut dhe sinjalet rrugore, Mjekësia dhe psikologjia në trafikun rrugor, Rregullimi i trafikut rrugor, Gjeografia e transportit, Transporti i udhëtarëve, Transporti i mallrave, Transporti i materialeve të rrezikshme, Praktika profesionale.	Shoferë të automjeteve të rënda, Koordinatorë të Logjistikës, Planifikues të Transportit, Mbikëqyrës të Dispeçimit, Ndërmjetës të Transportit, Menaxherë të Trafikut, Inspektorië të Sigurisë së Transportit, Teknikë të mirëmbajtjes së automjeteve, Analistë të transportit, etj.
	Profili:	**Transport dhe trafik - Transport rrugor**		

Jeni të shqetësuar për të ardhmen? Ndërtojeni sot. Ju mund të ndryshoni gjithçka.

Emri i shkollës	Lloji i shkollës - (Drejtimi/Profili)		Lëndët	Mundësitë e së ardhmës
Shtjefën Gjeçovi	Drejtimi:	**Teknike**	*Lëndët e përgjithshme:* Gjuhë shqipe dhe letërsi, Gjuhë angleze, Edukatë fizike, Kimi, Edukatë qytetare, Psikologji, Teknologji e informacionit dhe komunikimit, Ekonomi e ndërmarrësi, Matematikë aplikative, Fizikë aplikative, Menaxhim i projektit, Gjeografi, Histori. *Modulet profesionale*: Vizatim teknik, Elektroteknikë e mjeteve të transportit, Gjeografi e transportit, Bazat e transportit hekurudhor, Organizimi i trafikut hekurudhor, Organizim i transportit të mallrave, Organizim i transportit të udhëtarëve, Hekurudha dhe pajisjet hekurudhore, Shfrytëzimi i vagonëve, Transporti integral, Mjetet tërheqëse, kontabiliteti hekurudhor, Eksploatimi i mjeteve të tërheqjes, E drejta e transportit, Marketingu dhe shpedicioni, Praktikë profesionale.	Drejtues të trenit, Dispeçer të trenit, Kontrollues të trafikut hekurudhor, Inxhinier hekurudhor, Përcjellës hekurudhor, Teknikë të sinjaleve hekurudhore, Menaxherë të operacioneve hekurudhore, Teknikë të mirëmbajtjes hekurudhore, Inspektorë të sigurisë hekurudhore, Planifikues hekurudhor, etj.
	Profili:	**Transport dhe trafik - Lëvizje e Trenave**		

Emri i shkollës	Lloji i shkollës - (Drejtimi/Profili)		Lëndët	Mundësitë e së ardhmës
Gjin Gazulli	Drejtimi:	**Teknike**	*Lëndët e përgjithshme:* Gjuhë shqipe dhe letërsi, Gjuhë angleze, Matematikë, Teknologji e informacionit dhe komunikimit, Ekonomia dhe ndërmarrësia, Edukatë qytetare, Edukatë fizike, Fizikë, Menaxhim i projekteve, Psikologji. *Modulet profesionale*: Bazat e elektroteknikës, Vizatim teknik me dokumentacion, Materiale dhe komponentë elektrike, Bazat e elektronikës, Elektronikë digjitale, Pajisje periferike, Marrësit dhe antenat, Sistemet multimediale/audio/video, paisje të zyrës, Marrësit TV, Praktikë profesionale.	Teknikë të Elektronikës, Teknikë të Pajisjeve të Zyrës, Përfaqësuesi të Shitjeve të Elektronikës, Specialistë të Mbështetjes së Klientit, Inxhinierë Elektronikë, Inspektorië të Kontrollit të Cilësisë, Menaxherië të produktit, etj.
	Profili:	**Elektroteknikë - Elektronikë konsumuese dhe pajisje të zyrës**		
	Drejtimi:	**Teknike**	*Lëndët e përgjithshme:* Gjuhë shqipe dhe letërsi, Gjuhë angleze, Edukatë fizike, Matematikë e aplikuar, Edukatë qytetare, Teknologji e informacionit dhe komunikimit, Ekonomi dhe ndërmarrësi, Fizikë e aplikuar, Kimi e aplikuar, Menaxhim i projekteve. *Modulet profesionale*: Bazat e elektroteknikës, Matje elektrike, Materiale dhe komponente elektrike, Vizatim teknik me dokumentacion, Bazat e elektronikës, Baza të makinerisë, Makina elektrike I, Makina elektrike II, Pajisje elektrike, Instalime dhe ndriçime elektrike, Bartje të energjisë elektrike, Automatikë, Rrjete elektrike, Energjetikë e përgjithshme, Furnizim me energji elektrike i objekteve industriale, Elektronikë energjetike, Mbrojtje rele, Praktikë profesionale.	Teknikë të Elektronikës, Inxhinierë Elektrik, Teknikë të Shërbimit në terren, Teknikë të Prodhimit, Përfaqësues të Shitjeve të Elektronikës, Inxhinierë Testues: Specialistë të mbështetjes teknike, Instruktorë/trajnerë të elektronikës, etj.
	Profili:	**Elektroteknikë - Teknik i elektronikës**		

Emri i shkollës	Lloji i shkollës - (Drejtimi/Profili)		Lëndët	Mundësitë e së ardhmës
Gjin Gazulli	Drejtimi:	**Teknike**	*Lëndët e përgjithshme*: Gjuhë shqipe dhe letërsi, Gjuhë angleze, Edukatë fizike, Matematikë e aplikuar, Edukatë qytetare, Teknologji e informacionit dhe komunikimit, Ekonomi dhe ndërmarrësi, Fizikë e aplikuar, Menaxhim i projekteve. *Modulet profesionale*: Bazat e elektroteknikës, Matje elektrike, Materiale dhe komponente elektrike, Vizatim teknik me dokumentacion, Baza të elektronikës, Elektronikë digjitale, Algoritme, Arkitekturë kompjuteri, Sisteme operative, Rrjete kompjuterike, Gjuhë programuese, Aplikimet e kompjuterëve, Bazat e të dhënave, Teknologjitë e internetit (+ueb-dizajni), Mirëmbajtja dhe administrimi i rrjeteve, Baza të telekomunikacionit, Praktikë profesionale.	Specialistië të mbështetjes së TI-së, Teknikë të rrjetit, Administratorë të sistemeve, Analistë të sigurisë kibernetike, Administratorë të bazës së të dhënave, Koordinatorë të projektit IT, Përfaqësues të shitjeve të IT, Trajner IT: Konsulent IT, etj.
	Profili:	**Elektroteknikë - Teknik i informatikës**		
	Drejtimi:	**Teknike**	*Lëndët e përgjithshme*: Gjuhë shqipe dhe letërsi, Gjuhë angleze, Matematikë, Teknologji e informacionit dhe komunikimit, Ekonomia dhe ndërmarrësia, Edukatë qytetare, Edukatë fizike, Fizikë, Menaxhim i projekteve, Psikologji. *Modulet profesionale*: Bazat e elektroteknikës, Vizatim teknik me dokumentacion, Materiale dhe komponente elektroteknike, Bazat e telekomunikacionit, Bazat e elektronikës, Matje elektrike, Sisteme operative, Elektronikë digjitale, Algoritme, Gjuhët programuese, Bazat e të dhënave, Praktikë profesionale.	Zhvillues të softuerit, Zhvillues të Uebit, Administratorë të bazës së të dhënave, Analistë të sistemeve, Administratorë të rrjetit, Analistë të sigurisë kibernetike, Analizues të të dhënave, Menaxherë të Projektit IT, Specialistë të mbështetjes për IT, etj.
	Profili:	**Elektroteknikë - Informatikë**		

Emri i shkollës	Lloji i shkollës - (Drejtimi/Profili)		Lëndët	Mundësitë e së ardhmës
Gjin Gazulli	Drejtimi:	Teknike	*Lëndët e përgjithshme:* Gjuhë shqipe dhe letërsi, Gjuhë angleze, Edukatë fizike, Matematikë e aplikuar, Edukatë qytetare, Teknologji e informacionit dhe komunikimit, Ekonomi dhe ndërmarrësi, Fizikë e aplikuar, Menaxhim i projekteve. *Modulet profesionale:* Bazat e elektroteknikës, Matje elektrike, Materiale dhe komponente elektrike, Vizatim teknik me dokumentacion, baza të elektronikës, Baza të videoteknikës, Bazat e telekomunikacionit, Elektronikë digjitale, Akustikë, Video digjitale, Sistemet transmetuese, Mirëmbajtja e pajisjeve audio-vizuale, Bazat e projektimit audio-vizual, Sisteme të integruara audio-vizuale, Hyrje në komunikimin audio-vizual, Teknologjitë e transmetimit audio-vizual, Praktikë profesionale.	Teknikë të audios dhe videos, Inxhinierë të zërit, Teknikë të transmetimit, Instalues të pajisjeve audio/video, Specialistë të multimedias, Projektues të sistemit AV, Teknikë elektronikë, Specialistë të mbështetjes teknike, Konsulentë akustik, Asistentë të prodhimit, etj.
	Profili:	Elektroteknikë - Teknik i komunikimeve audio dhe video		

Suksesi nuk është gjë tjetër veçse disa rregulla të thjeshta të ndjekura çdo ditë, dhe dështimi është vetëm disa gabime të përsëritura çdo ditë. - Jim Rohn

Emri i shkollës	Lloji i shkollës - (Drejtimi/Profili)		Lëndët	Mundësitë e së ardhmës
Gjin Gazulli	Drejtimi:	Teknike	*Lëndët e përgjithshme:* Gjuhë shqipe dhe letërsi, Gjuhë angleze, Edukatë fizike, matematikë e aplikuar, Edukatë qytetare, Teknologji e informacionit dhe komunikimit, Ekonomi dhe ndërmarrësi, Fizikë e aplikuar, Menaxhim i projekteve. *Modulet profesionale*: Baza të elektroteknikës, Matje elektrike, Materiale dhe komponente elektrike, Vizatim teknik me dokumentacion, Baza të elektronikës, Baza të makinerisë, Makina I, Makina II, Pajisje elektrike, Instalime elektrike, Ngasje elektrike, Automatikë, Shqyrtimet e makinave, Energjetika e përgjithshme, Furnizimi me energji elektrike i objekteve industriale, Elektronikë energjetike, Mbrojtje rele, Praktikë profesionale.	Teknikë të Servisit, Teknikë të Infrastrukturës së Karikimit, Elektricistë të Automobilave, Konsulentë Shitës, Shofer Testimi, Teknikë të prodhimit, Teknikë të baterive, Instruktorë të teknologjisë, etj.
	Profili:	Elektroteknikë - Teknik i makinave elektrike		

Emri i shkollës	Lloji i shkollës - (Drejtimi/Profili)		Lëndët	Mundësitë e së ardhmës
